



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Priljeno Received / Delivered	05-12-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
S.KPMShCK	7682/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.861/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.861/2022 të datës 05.10.2022 të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi:

në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me numër të protokollit:994 të datës 30.09.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Kërkese nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 05.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.861/2022 të datës 05.10.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 05.10.2022 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është regjistruar me datë 05.10.2022 dhe numër protokollit:5889/2022, kundër Vendimit me numër të protokollit:994 të datës 30.09.2022 të Zëvendësuesit Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se institucionin punëdhënës nuk e ka zbatuar Vendimin e Këshilli A.nr.668/2022 të datës 09.09.2022 përmes të cilit ishte aprovuar ankesa e ankuesit e datës 27.07.2022. Po ashtu, ankuesi pretendon se përmes Vendimit të datës 30.09.2022 të Zëvendësuesit Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës është degraduar në pozitë në kuptim të nenit 32 të Ligjit për Zyrtarët Publik, ngase të njëjtit nuk i është mundësuar që ta ketë Akt emërimin e përhershëm për pozitën që do ta mbajë vetëm deri me datë 18.02.2023, ngase do të sistemohet në pozitën "Udhëheqës i Njesisë për Punë

dhe Aftësim Profesional në Burgun e Sigurisë së Lartë” si dhe Këshilli përmes vendimit A.nr.460/2022 të datës 28.06.2022 dhe Vendimit A.nr.478/2022 të datës 28.06.2022, ankuesve u kishte aprovuar ankesat duke e detyruar institucionin punëdhënës që kontratat ekzistuese me afat të caktuar t’ua shndërroje në akt emërimi të përhershëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueset në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, më datë 30.11.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Bazuar në kërkesën e Kryetarit të Kolegjit, me datë 15.11.2022 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK.nr.148/2022 përmes të cilit vendim, ankesës së ankuesit A.nr.861/2022 ia ka shtyrë afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë punë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.10.2022 me numër protokolli 5889/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër:995 të datës 30.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimin A.nr.668/2022 të datës 09.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-amilin e datës 30.11.02022 dërguar nga M.S për Këshillin; Diplomën e ankuesit të datës 08.03.2014 me numër:162/14; Diplomën e ankuesit të datës 08.11.2011 me numër:692/11.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha rrethanat ligjore për të **përfunduar procedimin administrativ** i filluar me ankesën e ankuesit **sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i provave materiale të lëndës ka gjetur se ankuesi në bazë të Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka të themeluar marrëdhënien e punës dhe mban pozitën “Drejtor i Qendrës Korrektuese në Dubravë”, për periudhën kohore nga datat 19.02.2018 deri më datë 18.02.2023. I njëjti me datën 27.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim që t’i rregullohet statusi i marrëdhënies së punës me akt emërimin të përhershëm sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Këshillin i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 09.09.2022 përmes vendimit A.nr.668/2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar duke e obliguar Menaxherin e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda pesëmbëdhjetë ditës (15) nga dita e pranimit të vendimit, ti ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për rregullimin e statusit të ankuesit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtar Publikë. Ndërsa me qëllim të zbatimit të Këshillit A.nr.668/2022 të datës 09.09.2022, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës përmes vendimit me numër:995 të datës 30.09.2022, ka zbatuar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, duke ia rregulluar ankuesit statusin e nëpunësit civil, gjegjësisht përmes vendimit të goditur me këtë ankesë është përcaktuar se ankuesi pas përfundimit të



kontratës së punës me datë 18.02.2023 do të sistemohet në mënyrë të përhershme pozitën "Udhëheqës i Njesisë për Punë dhe Aftësim Profesional" me akt emërim të përhershëm.

Kolegji i Këshillit përpara se të lëshohet në shqyrtim të pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e nenit 101 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike," dhe mbi këtë bazë ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankuesit të datës 05.10.2022, pasi që ankesa e palës është bazuar mbi të njëjtën situatë faktike dhe ka të njëjtin qëllim sikurse në ankesën e datës 27.07.2022 ku i njëjti kishte kërkuar që marrëdhënia e tij e punës t'i rregullohet në mënyrë të përhershme me akt emërim siç përcaktohet me nenin 32 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe të njëjtën ankesë Këshilli e ka shqyrtuar dhe ka vendosur përmes Vendimit A.nr.66/2022 të datës 09.09.2022, rrjedhimisht ankuesi brenda periudhës kohore prej pesë (5) muajsh ka parashtruar dy ankesa për të njëjtin qëllim dhe duke u bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka përfunduar procedimin administrativ të kësaj lënde.

Andaj theksuar si me sipër, u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.861/2022

Flakron Gashi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.